


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 12074 Rep.

Nr. 4007 Kol.



**KONTRATË DHURIMI KUOTE
E SHOQËRISË “GREEN on REPEAT” Sh.P.K.**

Sot, në Tiranë, më date 20.12.2019 (dymijë e nentembedhjete), përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilat më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi Kuotash.

Z. Arvin Kita, shtetas shqiptar, lindur me 01.10.1972 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. BG3480084 dhe nr. Personal H21001147H, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

Znj. Irena Kita, shtetase shqiptare, e bija e Andrea, lindur me 03.01.1982 ne Permet e banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. 028708249 dhe nr. personal I25103049A, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “*Dhuruesi*”);

Dhe

Z. Ermal Hysesani, shtetas shqiptar, lindur me 22.05.1990 ne Memaliaj, Tepelene e banues ne Tirane mbajtes i leternjoftimit me nr. 032568588 dhe nr. Personal J00522039U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “*Pranuesi i Dhurimit*”);

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesi dhe Pranuesi do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

MEQENËSE:

- a. Shoqëria “GREEN on REPEAT” Sh.p.k, eshte një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, NIPT L82413025Q dhe me seli ne TIRANE Rruga "Ymer Kurti", Nr. 4, Njësia Bashkiake Nr. 5, Qendra Tregtare Olimpia, Kati 0, pas Postës Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.
- b. Siç rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesit zotërojnë bashkarisht 40 % (dyzete përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe individualisht ortaku Arvin Kita zoteron 20 % (njetete përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Irena Kita zoteron 20% (njetete përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- c. Dhuruesi i ka njoftuar Pranuesit dëshirën e tij për dhurimin e 40 % (dyzete përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Pranuesi ka pranuar të fitojë kuotat e zotëruara nga Dhuruesit në Shoqëri sipas parashikimeve te kesaj Kontrate;

- d. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë dhe pasi transferimi i kuotave sipas kësaj Kontrate është miratuar sipas Vendimit bashkëlidhur të Ortakeve të Shoqërisë, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

1.1 Dhuruesi i dhuron dhe Pranuesi pranon të fitojë pronësinë nepermjet dhurimit mbi gjithsej 40 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë "GREEN on REPEAT" Sh.P.K, konkretisht 20% të kapitalit të zotëruar nga ortaku Arvin Kita dhe 20 % të kapitalit të zotëruar nga ortakja Irena Kita;

1.1. Kuotat janë të lira nga çdo barrë dhe të garantuar plotësisht sipas kushteve të kësaj Kontrate.

Neni 2 Deklarimet dhe garancite

2.1. Dhuruesit pranojnë se deklaratimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Dhuruesit ligjërisht e në momentin e nënshkrimit zotërojnë kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe kanë të drejtën për t'a transferuar kuotën.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë Dhuruesit.
- c. Çdo deklaratim apo garanci e dhënë nga Dhuruesit sipas kësaj Kontrate nuk përmban gabime materiale apo ometime.

2.2. Pranuesi pranon se deklaratimet e mëposhtme janë të vërteta, të plota dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a. Pranuesi ka tagra të plota për të pranuar kuotat nga Dhuruesit sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi.

Neni 3 Transferimi i të drejtave mbi kuotat

3.1. Pronësia mbi kuotën e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesit te Pranuesi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotes së Shoqërisë në favor të Pranuesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi

3.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, ortak i vetëm i Shoqërisë "GREEN on REPEAT" Sh.P.K. do të jetë:

- **Z. Ermal Hysesani *behet zotëruar i 1 (nje) kuote e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "GREEN on REPEAT" Sh.P.K.***

3.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.


Neni 4 Të ndryshme





- 4.1. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çënohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 4.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të çdo dispozite tjetër rregulluese sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm.
- 4.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.4. Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale dhe me vlerë të njëjtë provuese.

Kjo Kontratë pasi iu lexua Palëve me zë të lartë e të qartë, nga unë Noteri, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit dhe për gjithë efektet që passjell.


DHURUESIT








PRANUESI





NOTERI
JULIAN ZHELEGU



VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
“GREEN on REPEAT” SH.P.K.

Sot, me date 20.12.2019, asambleja e ortakeve te shoqerise “GREEN on REPEAT” Sh.P.K. (ne vijim “Shoqeria”), shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislicacionin shqiptar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS L82413025Q, me miratimin dhe pjesemarrjen e te gjithë ortakeve qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit, pasi shqyrtoi pikat e meposhtme te rendit te dites:

1. Dhenia e miratimit perkates per transferimin e kuotave permes dhurimit;
2. Te tjera eventuale;

Ne perputhje me Statutin dhe Ligjin 9901/2008, te ndryshuar, asambleja e ortakeve

VENDOSI:

1. Te miratoje transferimin, permes dhurimit, te 40% te kapitalit, konkretisht 20% te kapitalit te zoteruar nga ortaku Arvin Kita dhe 20 % te kapitalit te zoteruar nga ortakja Irena Kita ne favor te pranueses se dhurimit, ortakut tjetër te shoqerise Z. Ermal Hysesani. Marreveshja per dhurimin e kuotes sipas ketij vendimi mund te konkludohet pa asnje kufizim kohor pas miratimit te ketij vendimi. Kushtet e transferimit percaktohen lirisht nga palet kontraktore pa kufizim.
2. Ky Vendim depozitohet per regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” se bashku me marreveshjen perkatese te dhurimit te kuotave me qellim pasqyrimin e ndryshimeve ne te dhenat e regjistruara te Shoqerise duke autorizuar Znj. Albana Çopani, per depozitim e te gjitha akteve ne QKB.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“GREEN on REPEAT” Sh.P.K.

Arvin Kita

Irena Kita

Ermal Hysesani

